



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 168 prot.

Tiranë, më 19.01.2026

V E N D I M
Nr.15, Datë 19. 01.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 329, datë 29.12.2025, e paraqitur nga E.K kundër z. S.K , Këshilltar në Këshillin Bashkiak Vlorë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të gjinisë, racës dhe identitetit gjinor.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, pala ankuese parashtron:

“Më datë 27.12.2025, gjatë një situatë emergjente në qytetin e Vlorës, e shkaktuar nga mungesa e ujit të pijshëm për disa zona të qytetit, unë iu drejtova grupit zyrtar të këshilltarëve bashkiakë në aplikacionin WhatsApp, duke kërkuar informacion mbi funksionimin e shërbimeve të emergjencës dhe duke propozuar organizim vullnetar për t’i ardhur në ndihmë personave të moshuar, të cilët ishin grupi më i prekur nga kjo situatë.

Mesazhet e mia kishin karakter institucional, qytetar dhe humanitar dhe synonin reagim të përbashkët të Këshillit Bashkiak në shërbim të komunitetit.

Në këtë kontekst, z. S.K reagoi ndaj meje me gjuhë fyese, përçmuese dhe poshtëruese, duke përdorur shprehje si: “Ti lepin shumë”, “Mos e zgjat”, “S’ke nevojë për ujë”.

Këto shprehje janë përdorur në mënyrë direkte ndaj meje, në një komunikim zyrtar ndërmjet anëtarëve të Këshillit Bashkiak, dhe përbëjnë gjuhë denigruese, të papërshtatshme dhe intimidim verbal, duke cenuar rëndë dinjitetin tim personal dhe profesional.

Për më tepër, sjellja e tij synonte të më nënvlerësonte dhe të më heshte në ushtrimin e rolit tim si këshilltare bashkiake dhe si përfaqësuese e pakicave kombëtare, në një moment kur po mbroja interesin e qytetarëve dhe të grupeve vulnerabël.

Vlerësoj se jam trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe poshtëruese për shkak të:

- Statusit tim si grua në politikë
- Rolit tim si përfaqësuese e pakicave kombëtare (rom dhe egjiptian)
- Angazhimit tim publik për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve vulnerabël.

Sjellja e subjektit krijon një mjedis armiqësor, poshtërues dhe intimidues, duke më vënë në pozitë të pabarabartë me anëtarët e tjerë të Këshillit Bashkiak.

Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri:

- Regjistrimin dhe shqyrtimin e kësaj ankese.
- Konstatimin e diskriminimit dhe trajtimit poshtërues ndaj saj.
- Marrjen e masave administrative dhe rekomanduese ndaj subjektit.
- Rekomandime për garantimin e një klime respekti dhe barazie në këshillin Bashkiak Vlorë.
- Prandalimin e rasteve të ngjashme në të ardhmen.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Bazuar në nenin 3, pika 8, të LMD, gjuha e urrejtjes, parashikohet si një formë e veçantë diskriminimi me përkufizimin vijues: “8. *“Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.*”

Në ankesën nr. 329, datë 29.12.2025, ankuesja znj. E.K , pretendon se subjekti kundër të cilit ka paraqitur ankesën z. S.K , anëtar i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Vlorë, në grupin zyrtar të Këshilltarëve Bashkiakë të Bashkisë Vlorë në aplikacionin WhatsApp, në datën 27.12.2025, ka përdorur ndaj saj gjuhë fyese, denigruese, përçmuese dhe poshtëruese, një gjuhë të papërshtatshme, e cila cenon rëndë dinjitetin e saj personal dhe profesional. Ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese për shkak të statusit të saj si grua në politike, rolit të saj si përfaqësuese e pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane si dhe angazhimit të saj publik për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve vulnerabël, staturë/karakteristika këto që sipas ankueses përlligjin shkaqet e pretenduara si diskriminuese.

Bazuar në pretendimet e paraqitura nga ankuesja në ankesën objekt shqyrtimi, shprehjet e pretenduara si diskriminuese janë konkretisht: *“Ti lëpin shumë”, “Mos e zgjat” dhe “S’ke nevojë për ujë”*.

Referuar akteve të vendosura në dispozicion nga pala ankuese konstatohet se në aplikacionin *WhatsApp*, në grupin e emërtuar Këshilltarët Bashkiak PS, nga profili me emërtimin S.K , shkruhet mesazhi *“E. më është thar gjuha për ujë..ti lëpin shumë. mos e zgjat. ske nevoj për ujë”*. Në vijim të këtij mesazhi, ankuesja shkruan: *“Ke pirë? S’të ka hije kjo sjellje! Ky fjalor rrugësh, turp!”*. Komunikimi vijon edhe me mesazhe nga persona të tjerë ku diskutohet në lidhje me situatën e mungesës së ujit të Bashkinë Vlorë dhe masat që duhen ndërmarrë. Nga profili me emërtimin S.K , vijon komunikimi me mesazhin ku shkruhet: *“O E. nuk jeton ti vetëm me popullin. edhe ne jemi pjesë e qytetit. ti bën sikur vetëm ti punon në qytet. ki cik respekt për të gjithë këshilltarët.”*, ndërsa nga ankuesja shkruhet mesazhi *“Respekti nuk llogaritet në këto kushte. Organizim.Zgjim”*.

Nga analizimi i ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese, Komisioneri gjykon se shprehjet e përdorur nga z. S.K , Anëtar në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Vlorë *“... më është thar gjuha për ujë..ti lëpin shumë. mos e zgjat. ske nevoj për ujë”* drejtuar ankueses qoftë të marra të veçuara ashtu edhe duke i vendosur në kontekst të diskutimeve në tërësi të zhvilluara gjatë komunikimeve në aplikacionin *WhatsApp*, nuk krijon prezumimin se gjuha dhe shprehjet e përdorura ndaj ankueses, edhe pse mund të pretendohet se janë fyese, denigruese, poshtëruese, përçmuese dhe të papërshtatshme, t’i drejtohen ankueses për shkak të statusit të saj si grua në politikë, rolit të saj si përfaqësuese e pakicave rome dhe egjiptiane dhe angazhimit publik për mbrojtjen e të drejtave të

komuniteteve vulnerabël. Në këto kushte Komisioneri vlerëson se, haptazi gjuha e pretenduar si diskriminuese nuk bazohet në shkaqet diskriminuese të pretenduara nga ankuesja.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankesa në tërësi konsiderohet e pabazuar dhe përfundimi i arritur nga pala ankuese se shprehjet e përdorura nga z. S.K , Anëtar i Këshillit Bashkiak, Bashkia Vlorë, përbëjnë diskriminim për shkaqet e pretenduara nga ankuesja, është i pabazuar.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili parashikon se: “Ankesa nuk pranohet nëse: është haptazi e pabazuar.....”, ankesa nr.329 datë 29.12.2025 e paraqitur nga ankuesja znj. E.K , nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në referim të neneve 119 “Fyerja” dhe 120 “Shpifja”, të Kodit Penal, ku përcaktohet, respektivisht se:

*“Neni 119
Fyerja*

Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.

*Neni 120
Shpifja*

Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.”

Komisioneri rekomandon ankuesen që, pretendimet e saj mund t’i adresojë nëpërmjet procedurave civile ose penale gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 33, pika 4/ç, neni 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 329, datë 29.12.2025, të paraqitur nga znj. E.K , pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjinia, raca, identiteti gjinor
Fusha: Gjuhë urrejtje
Lloji i vendimit: Mospranim